



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2025:001209

Datë: 14.01.2025

Numri i dokumentit: 06707192

KF.nr.4/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen juridike sipas padisë së paditësit “IGMAS & LOGO” me numër unik identifikues 810839615 dhe seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhemajl Ademaj, avokat nga Malisheva, kundër të paditurit “Tulla Exclusive” me seli në Prishtinë, për kthim të borxhit dhe fitimit të humbur, jashtë seancës më 14.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar çështjen juridike sipas padisë së paditësit “IGMAS & LOGO” me seli në Prishtinë kundër të paditurit “Tulla Exclusive” për kthim të borxhit dhe fitim të humbur.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi kjo lëndë se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Komeriale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamentit për Çështje Ekonomike.

A r s y e t i m

Paditësi më 06.01.2025 ka ushtruar padi ndaj të Paditurit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që: të aprovet si e bazuar padia e tij lidhur me kthimin e borxhit dhe fitimin e humbur, të obligohet e paditura që në emër të borxhit t’ia kompensoj paditësit shumën në lartësi prej 5,6160.71 € dhe në emër të fitimit të humbur t’ia kthej shumën e cila do të përcaktohet pas nxjerrjes së ekspertizës përkatëse, si dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj të gjitha shpenzimet

procedurale sipas tarifës të OAK-së në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave tjera të lëndës, gjykata konstaton se Paditësi ka kërkuar nga një subjekt tjetër juridik kthimin e borxhit dhe fitimin e humbur, rrjedhimisht në bazë të nenit 19 dhe 392 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e shqyrtoi kompetencën e vet lëndore.

Nga padia e paditësit rezulton se ai nuk ka kërkuar anulimin apo shpalljen e pavlefshme të ndonjë akti administrativ dhe as nxjerrjen e një akti administrativ që nuk është lëshuar brenda afatit të parashikuar. Paditësi, duke pretenduar se i padituri, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ka detyrime të papërbushura ndaj tij, ka paraqitur kërkesën për kthimin e borxhit dhe kompensimin e fitimit të humbur.

Në bazë të pretendimeve të paditësit, palët ndërgjyqëse janë pajtuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre në momentin e lëshimit të faturës dhe marrjes së produkteve nga i padituri. Megjithatë, edhe pas furnizimit të mallit nga paditësi dhe kalimit të afatit për pagesë, i padituri nuk e ka përbushur detyrimin e tij për të kryer pagesën në mënyrë vullnetare.

Përveç mosrealizimit të borxhit kryesor, paditësi pretendon se kjo sjellje i ka shkaktuar dëm material në formë të fitimit të humbur, pasi moskryerja e pagesave me kohë i ka vështirësuar veprimtarinë afariste. Paditësi thekson se mungesa e mjeteve financiare të planifikuara ka ndikuar negativisht në mundësinë për të investuar dhe për të rritur biznesin e tij. Për më tepër, pavarësisht përpjekjeve të shumta për të kërkuar borxhin, paditësi deri më tani nuk ka arritur të realizojë rimbursimin e borxhit në tërësi.

Neni 13 para. 1, nën para. 1.12 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (këtu e tutje LGJK) përcakton se *“1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë (...) 1.11. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të*

Administratës Tatimore, Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore;”, ndërsa në para. 4. ka përcaktuar: “ Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.11 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti Fiskal;”.

Rrjedhimisht, për të gjykuar një çështje juridike në Departamentin Fiskal të Gjykatës Komerciale, ndër të tjera, kërkohet që të jetë kundërshtuar një akt administrativ përfundimtar. Në rastin konkret, paditësi ka parashtruar padi ndaj një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (ShPK) dhe jo ndaj ndonjë personi juridik publik që ka nxjerrë një akt administrativ apo ka kryer heshtje administrative, ligjshmëria e të cilave duhet të vlerësohet nga gjykata.

Kjo gjykatë vlerëson se mosmarrëveshja juridike e Paditësit me të Paditurin paraqet kontest tregtar ndërmjet dy shoqërive tregtare në kuptim të nenit 13 para.1 nën para.1.1 i LGjK-së, i cili ka përcaktuar se *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”.*

Prandaj, meqenëse paditësi, përmes padisë së tij, nuk ka kërkuar anulimin ose shpalljen e pavlefshme të ndonjë akti administrativ, as nxjerrjen e ndonjë akti administrativ që nuk është nxjerrë brenda afatit të parashikuar, por ka parashtruar kërkesë për kthimin e borxhit dhe kompensimin për fitimin e humbur, ky departament i kësaj gjykate vlerëson se nuk është kompetent për të gjykuar në këtë çështje. Rrjedhimisht, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke konstatuar se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Komerciale ka kompetencë lëndore për të gjykuar këtë çështje, në përputhje me nenin 13, paragrafi 2 i Ligjit për Gjykatat (LGjK). Ky nen përcakton shprehimisht se: *“2. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike.”*

Për këto arsye, Gjykata konform nenit 392 para. 1 nën para. b) të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së dhe dispozitat e lart cituara të Ligjit për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.4/25, datë 14.01.2025

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.